

UNIVERSITETI I PRISHTINËS  
FAKULTETI FILOZOFIK  
DEPARTAMENTI I HISTORISË

SHPEND AVDIU

REZYME E PUNIMIT TË DOKTORATËS

**Zhvillimet politike në Kosovë 1912-1915**

Prishtinë, 2017

Objekt i trajtimit të këtij punimi të doktoratës janë zhvillimet politike në Kosovë 1912-1915. Temën të cilën e kemi përzgjedhur ta trajtojmë, mendojmë se është trajtuar pak në përgjithësi, ose thënë më mirë, është trajtuar në mënyrë të tërthortë. Gjithashtu, mendojmë se deri më tani, në aspektin studimor, edhe ato pak vështrime që janë bërë për këtë periudhë, në mjaft raste dalin të ngarkuara nga pikëpamja ideologjike, qoftë komuniste dhe nacionaliste apo të ndonjë natyre tjetër. Si pikë e dytë që më ka shtyrë të merrem më këtë problematikë kanë qenë edhe zhvillimet e mëdha politiko-ushtarake në hapësirat e Kosovës gjatë viteve 1912-1915. Në këtë punim kemi bërë përpjekje t'i trajtojmë shkaqet dhe pasojat e këtyre zhvillimeve në këto territore.

Në këtë tezë doktrate, në aspektin gjeografik, do të përkufizohet territori që përfshinte Vilajetin e Kosovës. Kufijtë e Kosovës së sotme janë relativisht të vonshëm dhe nuk përkojnë me problematikën që trajtojmë. Megjithatë bazamenti dhe qendra që po trajtojmë mbeten territoret e Kosovës së sotme. Pushtimi i Kosovës dhe i territoreve të tjera në Ballkan, që ishin deri atëherë në kuadër të Perandorisë Osmane, nga shtetet ortodokse të këtij Gadishulli, e kishte zhdukur këtë kufi administrativ të Kosovës. Pas pushtimit të saj dhe të pjesëve të tjera evropiane të Perandorisë Osmane, këto territore njiheshin si Serbia e Re dhe si të tilla njiheshin deri në pushtimin austro-hungarez dhe bullgar në fund të vitit 1915. Ndërkaq, nuk kemi asnjë vijë kufitare definitive ndërmjet Malit të Zi dhe Serbisë, sepse disa territore të pushtuara nga Mali i Zi, siç ishte qyteti i Gjakovës, sipas Konferencës së Ambasadorëve të Londrës i takonin Serbisë. Po ashtu, edhe me ndarjen administrative të territoreve të pushtuara nga Serbia, që në fillim të shtatorit përveç qytetit të Pejës, shumica e këtyre territoreve bënin pjesë në të ashtuquajturën Serbi e Re. Madje, në këtë ndarje administrative, sipas Ministrisë së Punëve të Brendshme të Serbisë, në “territoret e çliruara” përfshiheshin edhe territoret e Plavës, Novi Varoshit dhe Pripoljes.

Dokumentet e materialet që kemi përdorë në këtë tezë të doktoratës janë marrë në arkivat dhe bibliotekat kombëtare dhe ndërkombëtare, si në Kosovë, në Shqipëri, në Turqi dhe në bibliotekat digjitale të Austrisë, të Francës dhe të Serbisë etj.

Në Agjencinë Shtetërore të Arkivave të Kosovës kemi hulumtuar dokumentet ushtarake serbe të viteve 1912-1915 për pushtimin e Kosovës dhe përgjithësisht trojeve shqiptare nga Serbia. Këto janë dokumente të Arkivit të Institutit Ushtarak në Beograd, dhe gjenden në Arkivin

e Kosovës. Më tej, kemi hulumtuar dokumentet e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Serbisë 1913-1915.

Gjithashtu, në Arkivin e Kosovës gjenden edhe koleksione dokumentesh të proveniencave të ndryshme. Ndër fondet më të pasura për këtë temë, për mendimin tonë, është ai i Sadullah Brestovcit, i pasur me dokumente të shumta serbe dhe austro-hungareze. Po ashtu, ndër fondet më të pasura të Arkivit të Kosovës, që kemi hulumtuar, është edhe fondi “Drita” i Rumanisë. Gjithashtu, për këtë temë iu kemi referuar dhe fondeve të tjera që ndodhen në Arkivin e Kosovës, siç është dhe ai i sektorit të dokumenteve të digjitalizuara, i pasur me materiale të ndryshme, me shtypin shqiptar, me letërkëmbime etj.

Në Arkivin Qendror të Republikës së Shqipërisë kemi hulumtuar fondin e Ismail Qemalit, Jani Vruhos, Hasan Prishtinës dhe të Bajram Currit, të cilat janë të pasura me materiale për zhvillimet në Kosovë, sidomos për periudhën 1912-1913, për qëndrimin e shqiptarëve ndaj zhvillimeve politike në atë kohë.

Në Arkivin e Institutit të Historisë-Tiranë kemi hulumtuar fondet e dokumenteve italiane, austro-hungareze, serbe, gjermane, ruse, bullgare. Këto dokumente janë të përkthyer pjesërisht edhe në gjuhën shqipe. Arkivi i Institutit të Historisë ka një vlerë të madhe për temën tonë, pasi që në të gjenden dokumente pothuajse për të gjitha aktet dhe zhvillimet politike në atë periudhë.

Gjithashtu, për këtë problematikë kemi hulumtuar edhe dokumentet osmane të viteve 1912-1914. Këto janë të botuara pjesërisht në gjuhën angleze dhe në gjuhën turke nga Arkivi Osman i Stambollit. Janë të pasura për rezistencën shqiptare, shpërnguljet e popullit shqiptar, krimet e ushtrive ballkanike etj. Në këto dokumente gjenden edhe akte të ndryshme diplomatike, që kanë vlerë të veçantë për temën në fjalë.

Si burime të dorës së dytë shpeshherë e kemi përdorur shtypin shqiptar dhe atë ndërkombëtar të asaj periudhe. Shtypi i huaj dhe ai shqiptar e trajton gjithanshëm gjendjen e përgjithshme në Kosovë, në Shqipëri, në Maqedoni, në Serbi, në Greqi, në Perandorinë Osmane, në Austro-Hungari, etj. Gjithashtu, përveç dokumentacionit të cilin e kemi analizuar, e kemi krahasuar edhe me literaturë relevante sidomos nga historiografia shqiptare, por duke mos e anashkaluar as atë rajonale, evropiane dhe turke.

Në këtë studim kemi vënë në përdorim metodat e analogjisë, analizës, deduksionit dhe të induksionit, metodat kuantitative (sasiore) dhe kualitative (cilësore) etj. Gjithashtu kemi caktuar kohën në të cilën është zhvilluar ngjarja dhe problematika, po ashtu, vend të rëndësishëm ka zënë dhe specifikimi i hapësirës dhe i kohës në të cilën janë zhvilluar ngjarjet.

Në hyrjen e punimit shkurtimisht i kemi trajtuar veçoritë kryesore të zhvillimeve politike-ushtarake në Kosovë në vitet 1908-1912, pastaj është trajtuar Kryengritja e Përgjithshme Shqiptare 1912, Kosova gjatë Luftës së Parë Ballkanike, Konferenca e Ambasadorëve në Londër 1912-1913, si dhe zhvillimet tjera politike të shtetit serb dhe të vendeve të tjera ballkanike që janë të ndërlidhura me zhvillimet politike në Kosovë. Objekt studimi janë edhe zhvillimet e kryengritjeve antiserbe në Kosovë 1913-1915, administrimi, kolonizimi, shpërnguljet, dhe pasojat e tjera siç janë krimet shtetërore, konvertimi i dhunshëm i shqiptarëve myslimanë dhe katolikë në ritin ortodoks.

Më poshtë do të japim më në detaje strukturën e punimit, i cili përveç pjesës hyrëse, përbëhet nga gjashtë kapituj.

**Në kapitullin e parë** kemi trajtuar Kryengritjen e Përgjithshme Shqiptare të vitit 1912; Zgjedhjet për Parlamentin Osman në Vilajetin e Kosovës; Shkaqet dhe organizimi i kryengritjes; Fillimi i Kryengritjes Shqiptare dhe Kuvendi i Junikut (21-24 maj 1912); Vazhdimi i kryengritjes gjatë muajve qershor - korrik; Bisedimet shqiptaro-osmane dhe kërkesat për autonomi si dhe faktorë të tjerë që e karakterizojnë. Në këtë kapitull u jemi referuar burimeve, osmane, austro-hungareze, shqiptare, serbe, bullgare e ruse, të cilat japin një pasqyrim mbi këto zhvillime në Kosovë.

**Në kapitullin e dytë** kemi trajtuar Kosovën gjatë Luftës së Parë Ballkanike, ku do të analizohet formimi i Aleancës Ballkanike dhe synimi i saj, më tej kemi trajtuar operacionet e ushtrisë serbe e malazeze dhe rezistencën e shqiptarëve në Kosovë gjatë Luftës së Parë Ballkanike, Betejën e Kumanovës dhe depërtimin e ushtrisë serbe në Manastir. Në këtë kapitull një vend të rëndësishëm zë qëndrimi i shqiptarëve ndaj Luftës së Parë Ballkanike dhe propaganda serbe për Kosovën gjatë luftës dhe para saj. Në këtë kapitull u jemi referuar kryesisht dokumenteve austro-hungareze dhe serbe, si dhe literaturës relevante shqiptare dhe të huaj.

**Në kapitullin e tretë** kemi trajtuar Konferencën e Ambasadorëve të Londrës, e cila ishte organizuar si pasojë e luftës në fjalë. Gjithashtu, në këtë punim është trajtuar edhe caktimi i

kufijve veriorë dhe verilindorë të Shqipërisë nga Konferenca e Ambasadorëve të Londrës, të cilët Kosovën do ta lënë në kuadër të shtetit serb, dhe qëndrimin e shqiptarëve ndaj Konferencës së Ambasadorëve në Londër. Për këtë pjesë të doktoratës u jemi referuar burimeve britanike, austro-hungareze, atyre serbe, dokumenteve dhe literaturës shqiptare dhe shtypit shqiptar të kohës etj.

**Në kapitullin e katërt** kemi trajtuar kryengritjet antiserbe gjatë viteve 1913-1915, si dhe shkaqet e pasojat që ato bartin me vete. Për këtë problematikë kryesisht u jemi referuar burimeve të ndryshme, si italiane, austro-hungareze, britanike, serbe, shtypit dhe literaturës relevante.

**Në kapitullin e pestë** jemi fokusuar në administrimin dhe kolonizimin e Kosovës 1912-1915, si dhe rregullimin administrativ të Kosovës 1912-1915.

**Në kapitullin e gjashtë** kemi trajtuar krimet serbo-malazeze në Kosovë (1912-1915): Konvertimi i popullsisë shqiptare në fenë ortodokse dhe në fund jemi marrë me shpërnguljen e popullsisë së Kosovës (1912-1915). Në këtë kapitull kemi përdorë burime të proveniencave të ndryshme si osmane, austro-hungareze, serbe, por më të plota dhe më interesante janë ato osmane dhe literatura historiografike turke, të cilat për këtë periudhë deri më tani pothuajse nuk janë përdorë fare. Përveç dokumenteve, në këtë kapitull kemi përdorur edhe Raportin e Komisionit Ndërkombëtar për Hetimin e Luftërave Ballkanike- Carnegie, ku jepen shumë të dhëna mbi krimet e ushtrisë serbe në Kosovë dhe në Maqedoni.

UNIVERSITY OF PRISHTINA  
FACULTY OF FILOSOPHY  
DEPARTMENT OF HISTORY

SHPEND AVDIU

**Political developments in Kosovo 1912-1915**

DOCTORAL THESIS OVERVIEW

Prishtina, 2017

This doctoral dissertation focuses on Kosovo's political affairs in the years from 1912 to 1915. We have decided to elaborate on this particular subject because we have found that it has been treated very little in general, or in an indirect manner. We also think that until now, in the research aspect, even the few insights given about this period, in many cases appear to be ideologically charged with either communist, nationalist or other ideological views. As a second point that has pushed me to deal with this issue were the major political-military developments in the areas of Kosovo during 1912-1915. This work is an attempt to elaborate the causes and consequences that these events have had on the territory they happened.

From the geographical aspect, this thesis will cover the territory that represented the Vilayet of Kosovo at the time. The borders of Kosovo today are relatively recent and do not correspond with the issue being dealt with in this work. However, the base and the center that we are dealing with the territories of today's Kosovo.

The occupation of Kosovo and of other territories in the Balkan, which were so far within the Ottoman Empire, by the orthodox states of this peninsula, had vanished this administrative boundary of Kosovo. After the occupation of Kosovo and other parts of Europe that used to pertain to the Ottoman Empire, these territories were known as New Serbia. They went under this name until the Austro-Hungarian and Bulgarian occupation by the end of 1915. Therefore, a definitive line of borders between Montenegro and Serbia was nonexistent because certain territories which were occupied by Montenegro like that of the town of Gjakova, according to the Conference of Ambassadors in London were initially assigned to Serbia. Moreover, with the administrative division of territories occupied by Serbia, since the beginning of September with the exception of the town of Peja, most of these territories fell under the so known New Serbia. Even in this administrative division, according to the Ministry of Internal Affairs of Serbia, in the “liberated territories” was also included the territories of Plava, Novi Varosh and Pripolje.

Nevertheless, the main focus in this writing will be the territory of today's Kosovo, but the entirety of the territory that used to be the Vilayet of Kosovo will also be taken into consideration. Whereas the time concerned, is that starting with the Albanian Insurrection of 1912 and ending with the Austro-Hungarian and Bulgarian occupation.

The documents and materials that were used for this doctoral thesis have been found in national and international archives and libraries, in Kosovo, Albania, Turkey and on digital libraries of Austria, France, Serbia, etc.

In the Kosovo Agency of State Archives, we have researched the documents of the Serbian military from years 1912-1915 on the occupation of Kosovo and the general Albanian territories by Serbia. These are documents of the Military Institute Archive of Belgrade that are found in the State Archive of Kosovo. Furthermore, we have researched the documents from the Ministry of Foreign Affairs of the Republic of Serbia of the years 1913-1915.

Also, there are collections of documents of different proveniences, in the Kosovo's Archive. Among the richest funds for this topic, in our opinion, is that of Saddam Brestovci, which is rich in numerous Serbian and Austro-Hungarian documents. Also, among the richest funds of the Archive of Kosovo, which we have researched, is Romania's fund called "Drita". We have also referred to other materials of the State Archive of Kosovo for this subject, plentiful documents from the digital section, the Albanian press, letters that were exchanged, etc.

In the Central Archive of the Republic of Albania, we have researched materials of Ismail Qemali, JaniVruho, HasanPrishtina and BajramCurri, all of which contain a lot of insights on the Kosovo affairs, especially during the period of time from 1912-1913, about the position of Albanians on the political affairs of the time.

In the Archive of Institute of History in Tirana there are a lot of materials from Italy, Austro-Hungaria, Serbia, Germany, Russia and Bulgaria. These documents are partly translated into Albanian. The Archive of the Institute of History is of special importance because it contains almost every political act and affair of the time, as well as the position that the Great Powers had about Kosovo.

Ottoman documents of years 1912-1914 have also been researched for this paper. They have partially been published in English and partially in Turkish from the Ottoman Archive in



Istanbul. They contain a lot of information about the resistance of Albanians, migrations of the Albanian population, the crimes of the military forces of the Balkans, etc. These documents also hold several diplomatic acts of crucial importance to the issue we are dealing with in this thesis.

As secondary source we have put to use is also former international press, comparing it to the Albanian press. The international press gives a multidimensional depiction of the state of Albanians in Kosovo, Albania, Macedonia, Serbia, Greece, Ottoman Empire and Austro-Hungary; and the circumstances in Kosovo in particular during this very crucial and very difficult time for Albanians and the people of Balkans in general.

Methods used in this work are: analogy, deductive and inductive analysis, qualitative and quantitative methods, etc. We have also selected a particular period of time the issues dealt with here pertain to, the time and space of the chosen subject are of great importance to this work.

This study opens with a brief description of the main political events in Kosovo between the years of 1908-1912, preceding with other important historical issues relevant to the topic, the Great Albanian Insurrection of 1912 as a subject of study, Kosovo during the First Balkan War, the Conference of Ambassadors in London, as well as other political events of the country of Serbia and other Balkan countries that are intertwined with Kosovo's affairs. The main focus of this study is the development of anti-Serbian insurrections in Kosovo from 1913-1915, the administration, colonization and migration and other consequences like state crimes and the violent religious conversion from Islam and Christianity to Serbian and Montenegrin Orthodoxy.

Further in this reading we go into the structure of the thesis in more detail, the first part consisting of 6 chapters in addition to the introduction.

**The first chapter** deals with the General Albanian Insurrection of 1912; The Elections for the Ottoman Parliament in the Vilayet of Kosovo; Causes and organization of the insurrection; The beginning of the Albanian Insurrection and the Junik Convention (May 21, 1912); The development of the insurrection June-July; The Albanian-Ottoman parley, the quest for independence and characteristic features. In this chapter we have referred to Ottoman, Austro-Hungarian, Albanian, Serbian, Bulgarian and Russian sources, taken from the archives of various libraries, that give us insights on the respective affairs in Kosovo.

**In the second chapter** we have elaborated on the circumstances in Kosovo during the First Balkan War, analyzing the forming of the Balkan Alliance and its mission, following the military operations of Serbia and Montenegro and the resistance of the Albanians of Kosovo during the First Balkan War, the Battle of Kumanova, the Serbian military break into Manastir. In this chapter, of significant importance is the Albanian resistance during the First Balkan War and the Serbian propaganda about Kosovo before and during this war. This chapter was mainly based on Austro-Hungarian and Serbian documents, as well as other relevant Albanian and international literature. Ottoman documents were also used for this chapter, giving a more detailed approach than that of previous writings.

**The third chapter** talks about the Ambassadors Conference in London which was held as an aftermath to the aforementioned war. The determination of the Northern and Northeastern borders of Albania in the Conference of London - an event that will exclude Kosovo from the Albanian territory by making it a part of Serbia, is also dealt with in this paper; as well as the stand of Albanians on the Ambassadors Conference in London. For this part of the paper we have referred to British, Austro-Hungarian and Serbian sources, Albanian literature, other international authors, the Albanian press of the time, etc.

**The fourth chapter** deals with the anti-Serbian insurrections of 1913-1915, their causes and consequences. The following subjects of study will be the September's Insurrection of 1913, September's Insurrection and the aggravation of Austro-Serbian relations, the insurrection of 1914, the Albanian movements against Serbia 1914-1915. Various sources have been consulted about these issues, such as; Italian, Austro-Hungarian, British, Serbian sources, the press and relevant literature.

**The fifth chapter** focuses on the colonization and administration of Kosovo 1912-1915 and the administrative regulation of Kosovo 1912-1915.

**The sixth chapter** is dedicated to crimes Serbs and Montenegrins committed in (1912-1915): The conversion of the Albanian population to the orthodox religion, and towards the end of this chapter we deal with the migration of people from Kosovo (1912-1915). For this chapter we have used various different sources like Ottoman, Austro-Hungarian, Serbian, but more thorough and interesting are the Ottoman sources like the Turkish geohistorical literature which has almost never been used until now for this specific period of time. Besides these documents,

we have also used Carnegie - the Report of the International Commission on the Balkan Wars in this chapter, where there is plenty of evidence over the crimes of the Serbian military forces in Kosovo and Macedonia.